



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot.,

Berat, më 15.10.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)
(Para Proçesit të Ankimimit)

Drejtuar: Operatorit ekonomik **KOLOSEU SHPK me Nipt J72603129H** përfaqësuar nga **Z. Jani Qosja**, me Adresë Lagjia 18 Shtatori, Urë Vajguore, Pall 8 katësh pranë Qendrës.

* * *

Proçedura e prokurimit: “Proçedurë e Hapur”, me objekt: “**Blerje Materiale Dekori**”, mallra, me fond limit: **14.450.833 (katërbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë tetëqind e tridhjetë e tre) lek pa tvsh.**

REF-20449-09-18-2024

Publikime të mëparshme (po): Buletini i Njoftimeve Publike **23.09.2024 Nr. 63**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë proçedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori ekonomik **ARTEO 2018 SHPK me NIPT L82523203F**

Oferta e operatorit ekonomik **13.792.500 (trembëdhjetë milion e shtatëqindë e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.**

2. Operatori ekonomik **Eleni Topi NIPT M22602204V.**

Oferta e operatorit ekonomik **13.272.500 (trembëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lek pa tvsh.**

3.Operatori ekonomik **FREDI ELECTRONIC NIPT K91803020F**

Oferta e operatorit ekonomik **10.991.500** (dhjetë milion e nëntëqindë e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

4.Operatoriekonomik **KOLOSEU SHPK me NIPT J72603129H**

Oferta e operatorit ekonomik **12.714.000** (dymbëdhjetë milion e shtatëqindë katërbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

5.Operatori ekonomik **MIFEEL me NIPT L82916601N.**

Oferta e operatorit ekonomik **10.870.000** (dhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

OFERTA TË KUALIFIKUARA;

Subjekti KOLOSEU SHPK me NIPT J72603129H.

SUBJEKTI ARTEO 2018 me NIPT L82523203F

OFERTA TË SKUALIFIKUARA:

1.Eleni Topi me NIPT M22602204V.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është i plotë dhe konkretisht sa më poshtë:

Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.1 të Kriterëve të veçanta të DST, (Kapacitetet ekonomike dhe financiare).

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre)viteve të fundit (2021, 2022,2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në referim të dokumentit të ngarkuar në sistem nga Op Ekonomik lidhur me **Vertetimin e xhiros vjetore** rezulton se nuk e përmbush xhiron vjetore me të paktën një vit së periudhës së kërkuar nga AK.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.

2.FREDI ELECTRONIC me NIPT K91803020F

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është i plotë dhe konkretisht si më poshtë:

Op Ekonomik nuk përmbush pikën **3.3.4 të DST (Kriteret e veçanta)**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **mostrat (kampionet)** nga dita e hapjes së procedurës deri ne ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për çdo zë objekt prokurimi në paketim origjinal. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Mostrat do paraqiten prane magazinës se ASHP (Rr. Baki Gjebrea, rajoni Nr. 1, Berat).

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Mosparaqitja e mostrave deri ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave përbën kusht për s’kualifikim.

OE nuk është paraqitur brenda afatit të kërkuar sipas pikes 3.3.4 të DST.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.

3.MIFEEL me NIPT L82916601N.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik në sistem, komisioni i vlerësimit të ofertave, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë konformë kërkesave të dokumentave standarte të tenderit. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është i plotë dhe dhe konkretisht sa më poshtë:

OP Ek pjesëmarrës **nuk përmbush:**

1.Piken **3.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **mostrat (kampionet)** nga dita e hapjes së procedurës deri ne ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për çdo zë objekt prokurimi në

paketim original. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Mostrat do paraqiten prane magazinës së ASHP (Rr. Baki Gjebrea, rajoni Nr. 1, Berat).

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Mosparaqitja e mostrave deri në ditën dhe orën e hapjes së ofertave përbën kusht për s’kualifikim.

OE nuk është paraqitur brenda afatit të kërkuar sipas pikes 3.3.4 të DST.

2.Nuk ka ngarkuar në sistem Sigurimin e ofertës sipas Kriteve të veçanta të DST.

3.Nuk përmbush piken **3.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) automjet të përshtatshëm për transport mallrash me kapacitet deri në 3,5 ton.** Në formularin përmbledhës të vetdeklarimit **Pjesa 3, Pika B**, në lidhje me deklarimin e mjeteve ka deklaruar se nuk disponon mjet.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos skualifikimin e këtij operatori në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **KOLOSEU SHPK me Nipt J72603129H përfaqësuar nga Z. Jani Qosja**, me Adresë Lagjia 18 Shtatori, Urë Vajgurore, Pall 8 katësh pranë Qendrës, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **14.450.833 (katërbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë tetëqind e tridhjetë e tre) lek pa tvsh,** [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITEIT KONTRAKTOR

Joana Melengu